

Buletin Tatimor

Kosovë • Tetor 2017



Kontaktet:

Loreta Peçi

Partnere Menaxhuese
Shqipëri & Kosovë
E-mail: loreta.peci@pwc.com

Gresë Rexhepi

Menaxhere
Tel: +386 49 714 666
E-mail: grese.rexhepi@pwc.com

Rr. Mujo Ulqinaku, No. 5,
Apt. 10, Kati 5
Qyteza Pejton
Prishtinë, Kosovo
Tel: +381 (0) 38 722 555
www.pwc.com/ks

Ky publikim përfshin zhvillimet e fundit në fushën e tatimeve në Kosovë siç janë kërkesa për raportim të transaksioneve të kontrolluara për vitin 2016 sipas Udhëzimit të Transferimit të Çmimit, marrëveshjet e reja për eliminimin e tatimit të dyfishtë të nënshkruara nga Republika e Kosovës, ndryshimet në procesin e rimbursimit tatimor, vendimin shpjegues publik mbi aplikimin e ngarkesës së kundërt dhe regjistrim elektronik për TVSH.

1. Kërkesa për raportim të transaksioneve të kontrolluara të vitit 2016

Pas hyrjes në fuqi të Udhëzimit Administrativ 2/2017 mbi Transferimin e Çmimit, Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) së fundmi ka publikuar njoftimin se tatimpaguesit që janë subjekt i kërkesave të këtij Udhëzimi duhet të dorëzojnë formularin “Njoftimi i transaksioneve të kontrolluara vjetore” deri më 30 Nëntor 2017 për transaksionet e kontrolluara të vitit tatimor 2016. Forma e këtij njoftimi është vënë në dispozicion nga ATK dhe ajo duhet të plotësohet dhe dorëzohet në ATK – Zyra Qendrore – Departamenti i Transferimit të Çmimit brenda këtij afati.

2. Kosova ratifikon marrëveshje të reja për eliminimin e tatimit të dyfishtë

Presidenti i Republikës së Kosovës ka ratifikuar tri marrëveshje për eliminimin e tatimit të dyfishtë në muajt e fundit. Këto përfshijnë marrëveshjet për shmangien e tatimit të dyfishtë me Konfederatën Zvicerane (Gusht 2017), Republikën e Kroacisë (Maj 2017) dhe me Emiratet e Bashkuara Arabe (Tetor 2016). Marrëveshjet e mësipërme hyjnë në fuqi pasi të përfundojnë procedurat e ratifikimit nga secili shtet respektivisht.

Kosova për momentin është në proces të negociimit të marrëveshjeve të reja të eliminimit të tatimit të dyfishtë me Republikën e Irlandës dhe Mbretërinë e Luksemburgut.

2.1. Zvicra

Njësia e përhershme: Marrëveshja mes Kosovës dhe Zvicrës thotë që një shesh ndërtimi apo projekt instalimi krijon njësi të përhershme vetëm nëse zgjat më shumë se 12 muaj.

Dividentët: Dividentët mund të taten në shtetin e rezidencës së përfituesit dhe në shtetin e burimit. Në rastin e kësaj të fundit, tatimi i ngarkuar nuk mund të tejkalojë 5% nëse rezidenti zotëron së paku 25% të kapitalit të kompanisë për 365 ditë, dhe 15% në të gjitha rastet e tjera. Dividentët përjashtohen nga tatimi nëse përfituesi është një fond pensional ose bankë qendrore.

Interesi: Interesi mund të taten në shtetin e rezidencës së përfituesit dhe në shtetin e burimit. Në rastin e kësaj të fundit, tatimi i ngarkuar nuk mund të tejkalojë 5%. Në situata të caktuara, interesi mund të taten vetëm në shtetin e rezidencës së përfituesit.

Të drejtat pronësore: Të drejtat pronësore taten vetëm në shtetin e rezidencës së përfituesit.

Metoda për eliminimin e tatimit të dyfishtë dallon mes dy shteteve. Kosova do të aplikojë metodën e kreditimit; kurse Zvicra mund të aplikojë metodën e kreditimit ose të përjashtimit varësisht nga lloji i të hyrave.

2.2. Kroacia

Njësia e përhershme: Marrëveshja mes Kosovës dhe Kroacisë parasheh që një shesh ndërtimi apo projekt instalimi krijon njësi të përhershme vetëm nëse zgjat më shumë se 12 muaj.

Dividentët: Dividentët mund të taten në shtetin e rezidencës së përfituesit dhe në shtetin e burimit. Në rastin e kësaj të fundit, tatimi i ngarkuar nuk mund të tejkalojë 5% nëse përfituesi zotëron së paku 25% të kapitalit të kompanisë, dhe 10% në të gjitha rastet e tjera.

Interesi: Interesi mund të taten në shtetin e rezidencës së përfituesit dhe në shtetin e burimit. Në rastin e kësaj të fundit, tatimi i ngarkuar nuk mund të tejkalojë 5%.

Të drejtat pronësore: Të drejtat pronësore mund të taten në shtetin e rezidencës dhe në shtetin e burimit. Në rastin e fundit, tatimi i ngarkuar nuk mund të tejkalojë 5%.

Kosova dhe Kroacia do të aplikojnë metodën e kreditimit për të eliminuar tatimin e dyfishtë.

2.3. Emiratet e Bashkuara Arabe

Njësia e përhershme: Marrëveshja mes Kosovës dhe EBA parasheh që një shesh ndërtimi apo projekt instalimi krijon njësi të përhershme vetëm nëse zgjat më shumë se 6 muaj. Poashtu, ofrimi i shërbimeve përmes punonjësve apo personelit krijon njësi të përhershme vetëm nëse këto aktivitete vazhdojnë për një periudhë më të gjatë se 6 muaj.

Dividentët: Dividentët mund të taten në shtetin e rezidencës së përfituesit dhe në shtetin e burimit. Në rastin e kësaj të fundit, tatimi i ngarkuar nuk

mund të tejkalojë 5%. Dividentët nuk taten nëse përfituesi është institucion qeveritar.

Interesi: Interesi mund të taten në shtetin e rezidencës së përfituesit dhe në shtetin e burimit. Në rastin e fundit, tatimi i ngarkuar nuk mund të tejkalojë 5%. Interesi nuk taten nëse përfituesi është institucion qeveritar.

Të drejtat pronësore: Të drejtat pronësore taten vetëm në shtetin e rezidencës së përfituesit.

Të dy shtetet do të aplikojnë metodën e kreditimit për të eliminuar tatimin e dyfishtë.

3. Rregullorja e brendshme mbi procedurat e rimbursimit tatimor

Në Shkurt 2017, ATK ka publikuar një rregullore të brendshme për periudhën dhe procedurat e rimbursimit të tatimit. Edhe pse ligji përcakton periudhën për shqyrtim dhe vendim të kërkesave të rimbursimit deri në 60 ditë, ATK me anë të këtij dokumenti e ka shkurtuar këtë periudhë kohore në më së shumti 30 ditë.

Rregullat e reja i kategorizojnë tatimpaguesit në tri grupe varësisht nga historia e tyre tatimore.

Kategoria A përfshin tatimpaguesit që kanë histori të mirë tatimore. Kjo kategori përfshin tatimpagues që kanë dorëzuar në kohë të gjitha deklaratat tatimore (dhe rrjedhimisht nuk i kanë korrigjuar ato) për periudhën nën rishikim, i kanë paguar të gjitha detyrimet tatimore në kohë, dhe kërkesat e tyre paraprake për rimbursim janë aprovuar me sukses.

Kërkesat e rimbursimit të këtyre tatimpaguesve do të shqyrtohen me procedurë të shpejtë, ku informacioni i marrë nga ta verifikohet pa pasur nevojë të bëhet kontrolli tatimor. Kohëzgjatja për shqyrtimin e kërkesave të tatimpaguesve të kësaj kategorie do të jetë më së shumti 7 ditë kalendarike.

Kategoria B përfshin tatimpaguesit që kanë histori më pak të favorshme tatimore. Kërkesat për rimbursim të kësaj kategorie do të shqyrtohen si në vijim:

- a) Nëse zyrtarët tatimor, përmes verifikimit të informacionit dhe dëshmive, vlerësojnë se kërkesa për rimbursim është e besueshme dhe procedura e kontrollit tatimor nuk është e nevojshme, ata rekomandojnë që rimbursimi të kryhet me procedurë të shpejtë deri në maksimum 7 ditë kalendarike;
- b) Nëse zyrtarët tatimor, përmes verifikimit të informacionit dhe dëshmive, vlerësojnë se të dhënat duhet verifikuar edhe me palët e treta, ata rekomandojnë që të fillojë procedura e kontrollit tatimor. Kohëzgjatja e kësaj procedure nuk do të tejkalojë afatin prej 20 ditësh kalendarike.

Kategoria C përfshin të gjithë tatimpaguesit tjerë, si dhe ata që dorëzojnë kërkesën e rimbursimit për herë të parë. Kohëzgjatja e procedurës për rimbursim në cilindo rast nuk duhet të tejkalojë afatin prej 30 ditësh kalendarike.

4. Vendim shpjegues publik mbi aplikimin e ngarkesës së kundërt

Në Gusht 2017, ATK ka publikuar një Vendim Shpjegues Publik mbi Aplikimin e Ngarkesës së Kundërt për shërbimet e blera jashtë Kosovës, duke ju referuar vendimeve C-95/07 dhe C-096/07 të Gjykatës Evropiane të Drejtësisë në lidhje kufizimet kohore për zbritjen e TVSH-së.

Në këtë Vendim Publik, ATK ka përcaktuar se nuk do të vlerësojë detyrim tatimor për TVSH në rastet kur ngarkesa e kundërt nuk është aplikuar si duhet dhe afati kohor për zbritjen e TVSH-së ka kaluar. Megjithatë, ATK ka bërë dallimin mes dy rasteve:

- 1) Kur tatimpaguesi i ka deklaruar gabimisht blerjet që janë subjekt i ngarkesës së kundërt në librat e TVSH-së, dhe rrjedhimisht nuk e ka aplikuar mekanizmin e ngarkesës së kundërt; në këto raste tatimpaguesi do të jetë subjekt i ndëshkimeve administrative por e drejta për zbritjen e TVSH-së për blerje që janë subjekt i ngarkesës së kundërt do t'i lejohet pavarësisht kufizimit 2 vjeçar siç parashihet me ligjin e TVSH-së. Në këto raste, ATK do të llogarit TVSH-në e pagueshme dhe njëkohësisht të zbritshme, me ç'rast nuk do të lindin detyrime për TVSH (vetëm ndëshkime për raportim të pasaktë).
- 2) Në anën tjetër, kur një tatimpagues nuk i ka raportuar fare këto blerje në librat e TVSH-së, dhe rrjedhimisht nuk e ka aplikuar mekanizmin e ngarkesës së kundërt ata nuk do të jetë vetëm subjekt i ndëshkimeve administrative, por do t'i kufizohet e drejta për zbritjen e TVSH-së sipas periudhës kohore të paraparë me ligj. Si përfundim, në rastet kur blerja e cila është subjekt i ngarkesës së kundërt nuk është përfshirë fare në libra të TVSH-së, e drejta për zbritjen e TVSH-së kufizohet, kurse TVSH e llogaritur do të vlerësohet, duke rezultuar kështu në obligime të TVSH.

5. Regjistrimi elektronik për TVSH

ATK ka njoftuar se duke filluar nga 28 Shtator 2017, tatimpaguesit mund të regjistrohen për TVSH dhe të gjenerojnë numrin e TVSH-së përmes sistemit elektronik EDI. Ata do të njoftohen në mënyrë elektronike për përfundimin e procedurës së regjistrimit, ndërkaq mund të marrin kopjen fizike të certifikatës së TVSH-së në zyrat përkatëse të ATK.

Si mund t'ju ndihmojmë?

PwC është ofruesi lider i shërbimeve tatimore në mbarë botën për nga madhësia, shtrirja dhe reputacioni në këtë fushë.

Klientët na angazhojnë sepse ne kombinojmë kuptimin e thellë të biznesit të tyre dhe rrethanave ekonomike me njohuri të specializuara në tatime në juridiksione në mbarë botën.

Pasi ligjet tatimore po bëhen gjithmonë më komplekse dhe planifikimi tatimor më i vështirë, ne i ndihmojmë kompanitë të:

- identifikojnë dhe zvogëlojnë rreziqet tatimore,
- kuptojnë dhe përmbushin detyrimet tatimore,
- zgjidhin mosmarrëveshjet me autoritetet tatimore kur ato lindin, dhe
- implementojnë strategji tatimore që plotësojnë objektivat e biznesit,



- menaxhojnë çështjet e kontabilitetit dhe raportimit.

PwC Kosovo shfrytëzon njohurinë dhe përvojën e saj vendore në fushën tatimore së bashku me ekspertizën dhe referencat e rrjetit në rajon dhe botë, për t'i ofruar klientëve shërbime të plota tatimore në shumë industri.

Për informacion të detajuar në lidhje me këtë ndryshim ligjor dhe se si PwC mund t'ju ndihmojë në përmbushjen e kërkesave të ligjeve tatimore në Kosovë, ju lutem [na kontaktoni](#) për të diskutuar më shumë.

Ky Buletin Tatimor është përgatitur nga PwC Kosovo, Departamenti i Tatimeve dhe Shërbimeve Ligjore.

Vërejtje ligjore: Materiali i përfshirë në këtë publikim shërben vetëm për qëllime të informacionit të përgjithshëm dhe nuk përmban një analizë të plotë të elementeve të përshkruara. Para marrjes (apo mos marrjes) të ndonjë veprimi, çdo lexues duhet të kërkojë këshilla profesionale specifike për situatën e tyre. Asnjë përgjegjësi nuk pranohet për veprimet ose mosveprimet e ndërmarra në mbështetje të përmbajtjes së këtij publikimi.

Tek PwC, qëllimi jonë është që të fitojmë besimin në shoqëri dhe të zgjidhim probleme të rëndësishme. Ne jemi një rrejt kompanish në 157 vende me më shumë se 223,000 njerëz të cilët janë të përkushtuar në ofrimin e shërbimeve cilësore të auditimit, tatimeve dhe këshillave. Informohuni dhe na tregoni se çfarë është me rëndësi për ju tek www.pwc.com. PwC i referohet rrjetit të PwC dhe/ose një apo më shumë anëtarëve të tij, ku secili është një entitet i ndarë ligjor. Ju lutem shihni www.pwc.com/structure për më shumë detaje.

©2017 PwC. Të gjitha të drejtat e rezervuara.